

Katër të ndaluar për një rast rrëmbimi në Veternik, mes tyre edhe një polic

LAJME



20/10/2025 20:30

f

t

l

Katër persona, në mesin e tyre edhe një zyrtar policor janë ndaluar si të dyshuar për përfshirje në një rast rrëmbimi.

Kështu njofton komunikata e Inspektoratit Policor të Kosovës.

Në njoftimin e IPK-së thuhet se rasti ka ndodhur më 19 shtator 2025 në lagjen Vetërnik.

“Menjëherë pas kësaj është njoftuar Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), të cilët në bashkëpunim me hetuesit e Njësisë së Hetimeve të Përgjithshme në Prishtinë kanë arritur të sigurojnë prezencën e personave të dyshuar. Gjatë veprimeve hetimore janë sekuestruar një armë zjarri dhe një lodër (imitim i armës AK-47). Me vendim të Prokurorisë Themelore të Prishtinës, të katër personave të ndaluar u është caktuar masa e ndalimit prej 48 orësh”, thuhet në njoftimin e IPK-së.

Si pjesë e procedurave administrative IPK i ka rekomanduar Policisë së Kosovës edhe suspendimin për zyrtarin policor.

“Hetuesit policor dhe ata të IPK-së, në koordinim të plotë me Prokurorinë Themelore, po vazhdojnë veprimet e mëtejme hetimore me qëllim të ndriçimit të plotë të rastit.Numri i përgjithshëm i personave të arrestuar lidhur me këtë rast arrin në tetë”.

LAJME TË FUNDIT



Mushkolaj për koalicionin VV-LDK në Vushtrri: Asnjë parti...



Haziri për koalicionin në Vushtrri: Kurti po “targeton”...



Ramabaja: Fokusi është vetëm te balotazhi, po shkojmë...



Hoxha: Zyrtarët policorë që kryejnë veprën penale “Dhunë...

Artikuj të ngjashëm



October 20, 2025

Mushkolaj për koalicionin VV-LDK në Vushtrri: Asnjë parti s'ka thënë se...



October 20, 2025

Haziri për koalicionin në Vushtrri: Kurti po “targeton” dhe po i...



October 20, 2025

Ramabaja: Fokusi është vetëm te balotazhi, po shkojmë në zgjedhje të...



October 20, 2025

Hoxha: Zyrtarët policorë që kryejnë veprën penale “Dhunë në familje” nuk...



October 20, 2025

Pas ngjarjeve të fundit, reagon Abdixhiku paralajmëron përgjigje me kohë për...



October 20, 2025

Qeveria në pikëpyetje: Afati afrohet, shenja nuk ka

Other Links